



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 01
Prishtinë, më 23 janar 2013, në orën 10:00, salla N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatore; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kelmendi-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.12.2012
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2012;
5. Te ndryshme

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.12.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.12.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2012

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me përmbajtjen e raportit. Tha, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka punuar sipas Rregullores së Kuvendit, sipas Rregullave të Procedurës të Komisionit dhe sipas Planit të Punës të Komisionit. Komisioni ka mbajtur gjithsejtë 31 mbledhje të rregullta. Në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, lidhur me çështjet e shqyrtuara në Komision, janë përgatitur raporte dhe rekomandime për Kryesinë dhe për deputetët e Kuvendit. Me ftesë të Komisionit, në takime kanë prezantuar përfaqësues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përfaqësues të ministrave (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera buxhetore. ZAP ka planifikuar 4 auditime të performances, por ka dorëzuar vetëm 2 raporte të auditimit të performances. Prej raporteve të shqyrtuara, Komisioni ka renditur për shqyrtim gjithsejtë 60 raporte-përfshirë edhe raportet e Komunave. Lidhur me këto raporte, Komisioni ka nxjerr Rekomandime, disa prej të cilave ishin edhe objekt diskutimi në mbledhjet plenare të Kuvendit. Komisioni ka bërë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, si dhe ka mbajtur një dëgjim publik, në të cilën ka shqyrtuar të gjitha raportet e Auditimit të komunave për vitin 2011. Raportet të mbetura në procedurë “*të papërfunduara*”, janë si rezultat i mos pjesëmarrjes në mbledhje, i përfaqësuesve të ftuar nga Komisioni. Në kuadër të fushëveprimit të tij, Komisioni mbikëqyrë edhe zbatimin e Rekomandimeve të ZAP-it dhe të Komisionit. Në kuadër të kësaj, Komisioni ka kërkuar Raporte kthyesë, njoftime zyrtare dhe Plan Veprimi, nga institucionet lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it. Pjesa e Raportit përmban edhe një vlerësim të Komisionit, e për të cilën pjesë anëtarët e Komisionit, mund të japin kontributin tyre. Si vlerësim i përgjithshëm mendoj se Komisioni gjatë vitit 2012, ka arritur të kryej objektivat në mënyrë të kënaqshme. Dhe si rezultat i punës së Komisionit disa nga Organizatat buxhetore kanë arritur progres të kënaqshëm krahasuar me vitin e kaluar. Shqetësuese për Komisionin, mbetet adresimi i rekomandimeve dhe përgjigja në kërkesat e Komisionit. Mos pjesëmarrja e ministrave në mbledhjet e Komisionit, shpeshherë ka qenë pengesë në punën efektive të tij. Sipas Vlerësimit të Komisionit, për Organizatat Buxhetore sfidë mbeten: procesi i prokurimit - *ka pasur lëshime pothuajse në të gjitha OB*, regjistrimi i pasurisë – *akoma përbënë sfidë për Organizatat Buxhetore, proces ky që nuk është përshkruar në harmoni me dispozitat ligjore*. auditimit të brendshëm nga OB – *edhe pse janë themeluar komitetet e auditimit, shqetësuese mbetet se auditorët e brendshëm akoma merren me auditime të vitit paraprak e jo me auditime të vitit aktual*. Pastaj, *ka pasur raste kur rekomandimet e auditorëve të brendshëm nuk janë përfillur fare nga menaxhmenti*, sfidë për ZAP-in akoma mbetet auditimi i performancës. Vlerësimi i përgjithshëm është se Komisioni, përkundër vështirësive, me punën e tij, ka arritur ta mbrojë qëllimin e tij, e ajo është mbrojtja e shpenzimit të parasë publike.

Valbona Dibra - Përgëzoi stafin për mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit me këshilla ligjore procedurale dhe profesionale. Po ashtu tha se Raporti është një përmbledhje e mirë e punës së Komisionit. Raporti është mjaft i detajuar dhe gjatë vitit 2012 përkundër sfidave, Komisioni ka bërë një punë shumë të mirë. Lidhur me pjesën e vlerësimit të Komisionit, ishte e mendimit që kjo pjesë duhet të përmbajë edhe të dhëna lidhur me progresin e Organizatave Buxhetore, sepse jemi dëshmitar se shumë Organizata Buxhetore: si Ministria e Bujqësisë, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, Këshilli Gjyqësor etj, kanë treguar shumë progres krahasuar me vitin e kaluar. Sfidë mund të përmendet mos adresimi i rekomandimeve. Pastaj, prezenca e ministrave në mbledhjet e Komisionit ka qenë e kënaqshme, sepse pothuajse të gjithë ministrat i janë përgjigjur ftesës së Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti Vjetor i Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave publike, për vitin 2012.

4. Të ndryshme

a). Mbledhjet e radhës të Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se ZAP, akoma nuk ka proceduar Planin e Punës për vitin 2013. Kryesia e Kuvendit, ka kërkuar që plani i punës së Komisioneve të procedohet deri më datë 28 janar 2013. Po ashtu njoftoi anëtarët e Komisionit se ka kërkuar nga ZAP-i, që të përfshijë në plan të punës edhe auditimin e performancës për: Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike.
Propozoi që Komisioni ditën e premte, datë 25 janar 2013, të mban edhe një mbledhje për të shqyrtuar planin e punës së Komisionit, për vitin 2013.

Valbona Dibra - Tha se Komisioni duhet të dal me një plan pune të tij, pavarësisht nga plani i punës së ZAP-it. Mund të marrim të dhëna orientuese edhe nga plani i vitit të kaluar. Lidhur me propozimin e kryetarit për auditim të performancës, kjo tashmë është vonë, sepse me ZAP-in, Komisioni ka diskutuar në muajin shtator se cilat OB do të auditohen.

Ramiz Lladrovci – Komisioni në vazhdimësi ka kërkuar auditime të performancës, për ministrinë në fjalë. Kërkoi nga zyrtari ndërlidhës i ZAP përgjigje se kur mund të presim të dhëna nga ZAP-i.
Stafi i Komisionit ka përgatitur një draft dhe të njëjtin propozoi që ta miratoj Komisioni.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Mbledhja e radhës e Komisionit mbahet ditën e premte, datë 25 janar 2013, ora 09:00. Në këtë mbledhje do të shqyrtohet draft plani i punës së Komisionit.*
2. *Shqyrtimi i Raportit Vjetor të performancës së ndërmarrjeve Publike, mbahet në muajin shkurt.*

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

VENDIM

1. **Eksperti Mustafë Hasani, angazhohet për shqyrtimin e Raporteve të performancës dhe të auditimit të Ndërmarrjeve Publike. I njëjti shqyrton edhe raportin vjetor të performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2011, dhe Komisionit i paraqet raport me rekomandime.**
2. **Shpenzimet për angazhimin e ekspertit, barten nga Buxheti i Komisionit.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu